



VENDIM

Nr. 32 Date 22.04.2009

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“PURO ENERGY STEBLEVA” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma a, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma a, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma a, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22 .04.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k., për t’u liçensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi:

- Paraqitjen e aplikimit konform përcaktimeve të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”,

Vendosi:

1. Të fillojë proçedurat për liçensimin e shoqërisë “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta**